



REPUBLIKA E SHQIPËRISË
BASHKIA FUSHË-ARRËZ

Procesverbal -Tipi i kontrates - Pune

PËR ARGUMENTIMIN DHE MIRATIMIN E SPECIFIKIMEVE TEKNIKE DHE KRITEREVE PËR KUALIFIKIM

(Ky procesverbal është për efekt publikimi bashk dokumentat e tenderit)

OBJEKTI I PROCEDURËS – “Rikonstruksion i kopshtit te femijeve Fushe-Arrez, Bashkia Fushe-Arrez”

KODI PËRKATËS NË FJALORIN E PËRBASHKËT TË PROKURIMIT (CPV): 45112400-9 Punime germuese

VLERA E FONDIT LIMIT – 42 811 775 (dyzet e dy milion e teteqind e njembedhjet mije e shtateqind e shtatedhjet e pese) leke pa tvsh

Në bazë të nenit 77, të Ligjit nr.162/2020 “Për prokurimin publik”, në VKM nr.285, datë 19.05.2021 “Për miratimin e rregullave të prokurimit publik” neni 39, autoriteti/enti kontraktor **Bashkia Fushë-Arrez**, ka hartuar procesverbalin për argumenimin dhe miratimin e specifikimeve tenike dhe kriterëve për kualifikimin për procedurën e sipercituar, me përmbajtjen si më poshtë:

KRITERET E VEÇANTA TË KUALIFIKIMIT

Kandidati/ofertuesi duhet të dorëzojë:

- a. Sigurim oferte, sipas Shtojcës 3;*
- b. Formulari përmbledhës i vetdeklarimit, sipas Shtojcës 8*

Argumentimi: *Kriteri (a) eshte vendosur ne baze te nenit 83 të LPP dhe nenit 30 pika 1 te VKM-së Nr.285, datë19.5.2021 “Për Miratimin e Rregullave të Prokurimit Publik”, i ndryshuar. Kriteri (b) bazohet në nenet 76, 77 dhe 82 të LPP si dhe nenit 26 të VKM nr. 285, datë 19.05.2021 “Për miratimin e rregullave të prokurimit publik”, i ndryshuar.*

Kapaciteti ekonomik dhe financiar:

2.2.1 Për të provuar kapacitetet financiare dhe ekonomike, operatorët ekonomikë duhet të paraqesin vërtetim për xhiron vjetore për 3 vitet e fundit financiare 2021,2022,2023 ku vlera e xhiros minimale vjetore për të paktën një nga vitet e periudhës së kërkuar nuk mund të tejkalojë vlerën e parashikuar të kontratës..

Argumentimi: Kërkesa e mësipërme është përcaktuar bazuar në vlerën e fondit limit të kësaj procedure, si dhe bazuar në nenin 77, pika 3, e LPP, si dhe nenin 43 shkronja b, të VKM nr. 285, datë 19.05.2021 “Për miratimin e rregullave të prokurimit publik” i ndryshuar . Përcaktimi i vlerës së kërkuar argumentohet si më poshtë: Vendosija e këtij kriteri kualifikues i sherben Autoritetit Kontraktor për të vërtetuar se operatori ekonomik fitues i zoteron të gjitha kapacitetet ekonomike dhe financiare për të përmbushur me sukses kontratën.

2.2.2 Operatorët ekonomikë duhet të paraqesin bilancet vjetore, për vitet financiare 2021, 2022, 2023 të shoqëruara me Akt Ekspertizën e Ekspertit Kontabël të Autorizuar, në rastin kur janë në kushtet e përcaktimeve në përputhje me Ligjin nr.10091,date 05.03.2009 "Për auditimin ligjor,organizimin e profesionit të ekspertit kontabel të regjistruar dhe të kontabilistit të miratuar", i ndryshuar, Kreu V, neni 41, pika c. Kjo kërkesë konsiderohet e përmbushur nëse në dy bilance të njëpasnjëshme, nuk ka raport negativ ndërmjet aktivitetit dhe pasivitetit.

Argumentimi: Kërkesa e mësipërme është vendosur referuar nenin 43, pika 4 të VKM-së Nr.285 datë 05.03.2021 “Për Miratimin e Rregullave të Prokurimit Publik” I ndryshuar , si dhe bazuar në Nenin 77 pika 3, e LPP nr.162, datë 23.12.2020 “Për Prokurimin Publik”, si dhe Ligjin nr.10091“Për auditimin ligjor, organizimin e profesionit të ekspertit kontabël të regjistruar dhe të kontabilistit të miratuar”, i ndryshuar, Kreu V, neni 41, pika c. i cili parashikon se: “Personat juridikë që detyrohen për auditimin ligjor të pasqyrave financiare detyrohen të kryejnë auditimin ligjor të pasqyrave financiare vjetore, përpara publikimit të tyre, nga eksperte kontabël ose shoqëri audituese: "c) shoqëritë me përgjegjësi të kufizuar, të cilat zbatojnë për raportimin financiar standardet kombëtare të kontabilitetit, kur, në mbyllje të periudhës kontabël, për dy vite radhazi, tejkalojnë dy prej tre treguesve të mëposhtëm Përcaktimi i viteve të kërkuara për paraqitjen e bilanceve është bërë duke iu referuar legjislacionit të fushës, konkretisht, në Ligjin nr. 9920 date 19.05.2008 ”Për Procedurat Tatimore në Republikën e Shqipërisë” i ndryshuar, dhe aktet nenligjore në zbatim të tij. Kërkesa për paraqitjen e bilanceve është vendosur duke pasur në konsideratë objektin e kontratës, natyrën dhe volumin e saj, që t’i shërbejnë autoritetit kontraktor për njohjen e gjendjes dhe kapaciteteve të operatorëve ekonomikë, të cilët, nëpërmjet dokumentacionit të paraqitur duhet të vërtetojnë se zotërojnë kapacitetet e nevojshme, gjithçka në funksion të realizimit me sukses të kontratës.

2.2.3 Operatori Ekonomik duhet të paraqesë një dokument që vërteton se ka plotësuar të gjitha **detyrimet e taksave dhe tarifave vendore**, lëshuar nga Pushteti Vendor, **për vitin 2023** referuar ligjit nr. 9632, datë 30.10.2006 “Për sistemin e taksave vendore”, si dhe sipas Vendimit të Këshillit Bashkiak përkatës ku subjekti ushtron aktivitetin, lëshuar nga Administrata e Qeverisjes Vendore (Në rastet e bashkimit të operatorëve ekonomikë, çdo anëtar i grupit duhet të dorëzojë këtë dokument në momentin e dorëzimit të dokumentave).

Argumentimi: Ky kriter është vendosur bazuar në nenin 76, pika 2 të LPP si dhe në ligjin Nr.9632, datë 30.10.2006 “Për sistemin e taksave vendore” i ndryshuar, neni 5, pika c. Kjo kërkesë bazohet në Ligjin nr.9632,date 30.10.2006 ,Për sistemin e taksave vendore i ndryshuar, neni 5, pika c, sipas afateve të miratuara të kryerjes së pagesave të përcaktuara nga cdo njesi e qeverisjes vendore .

2.3 Kapaciteti teknik:

2.3.1 Përvojë e suksesshme në ekzekutimin e të paktën:

a-Punë të ngjashme për një objekt të vetëm në një vlerë jo më e madhe se 50 % e vlerës së përllogaritur të kontratës që prokurohet dhe që është realizuar gjatë pesë viteve të fundit, nga data e shpalljes së njoftimit të kontratës.

b) punë të ngjashme deri në një kufi, ku vlera monetare totale e punëve të kryera, e marrë së bashku gjatë pesë viteve të fundit, është jo më e vogël se dyfishi i vlerës limit e kontratës që prokurohet.

-Për të vërtetuar përvojen e mëparshme duhet të paraqiten:

a. Nëse kontrata është realizuar me institucione shtetërore:

- Formulari i vlerësimit
- Kontratë punimesh;
- Situacion përfundimtar;
- Çertifikaten e marrjes ne dorezim .

b.Nëse kontrata është realizuar me subjekte private:

- Kontratën e punimeve,
- Situacionin përfundimtar,
- Çertifikaten e marrjes ne dorezim.
- Faturën tatimore te situacionit përfundimtar.

Plotësimi i njërit prej dy kushteve të sipërpërmendura për përvojen e suksesshme e bën ofertën të kualifikueshme.

Per kontratat e realizuara si Bashkim Operatoresh, operatori ekonomik ofertues duhet te paraqesë:

- Kontraten e bashkimit te operatoreve dhe prokuren e posacme te deklaruar ne fazen e tenderimit;

***Argumentimi:** Kërkesa e mësipërme është përcaktuar bazuar në nenin 77, të ligjit nr. 162, datë 23.12.2020 “Për prokurimin publik” dhe nenit 39, pika 5, të VKM nr. 285, datë 19.05.2021 “Për miratimin e rregullave të prokurimit publik”, i ndryshuar. Me anë të këtij kriteri kërkohet që operatorët ekonomikë të dëshmojnë që kanë përvojën e nevojshme për të zbatuar kontratën, prandaj është kërkuar që punët e mëparshme të ngjashme të jenë minimalisht në vlerat 50 % të vlerës së fondit limit, për një objekt të vetëm, ose jo me te vogël se dyfishi i vlerës limit të objektit te prokurimit për punët totale të ngjashme të kryera në 5 vitet e fundit, që janë brenda vlerave kufi të përcaktuara në nenin e sipërcituar. Ky kriter eshte vendosur edhe per shkak te specifikes qe ka objekti pasi mundesie e akomodimit te femijeve na ambiente te tjera te pershtatshme i kemi te kufizuara. Kjo edhe per faktin tjeter pasi ne objektet shkollore te arsimit parauniversitar (mundesi akomodimi) kryejm cdo vit punime rehabilitimi per pergatitje e tyre per vitin e ardhshme shkollor. Për kontratat e realizuara si Bashkim Operatoresh, operatori ekonomik ofertues, është kërkuar edhe paraqitja e kontratës së bashkimit te*

operatoreve shoqeruar me tabelën e ndarjes së punimeve, ku te cilësohen punimet që ka marrë përsiper të kryejë secili anëtar i BOE, mbështetur në parashikimet e nenit 88 të VKM nr. 285, datë 19.05.2021 “Për miratimin e rregullave të prokurimit publik”, të ndryshuar. Me anë të këtij dokumentacioni AK ka mundësi të njihet me vlerën reale të punimeve të realizuara nga ofertuesi/t, mbi bazën e një kontrate të realizuar si BOE

2.3.2 Liçensa profesionale e shoqërisë për realizimin e punimeve, objekt i kontratës:

Operatori Ekonomik duhet të disponoje Liçencë të shoqërisë e vlefshme për kategoritë e mëposhtme:

- NP – 1/A (Punime gjurmimi ne toke.)
- NP – 2/A (Ndertime civile dhe industriale)
- NP – 3/A (Rikonstruksion dhe mirembajtje godinash civile e industriale,veshje fasade
- NP – 12/A(Punime të inxhinierisë së mjedisit.)

Për punimet speciale të ndërtimit duhet të ketë licensat e mëposhtme:

- NS – 1/A (Punime per prishjen e ndertimeve)
- NS – 2/A (Impiant hidro-sanitar, guzhina, lavanteri, mirembajtje e tyre)
- NS – 4/A (Punime rifinature te muratures dhe te lidhura me to, rifinature me materiale druri,plastike, metalike, dhe xhami dhe rifiniture te natyres teknike ndertuese)
- NS – 12/A (Impiant teknologjik, termik dhe kondicionimit)
- NS - 14/A (Impiante te brendshme, elektrike, telefoni, radiotelefoni TV etj)
- NS - 18/ A (Punime topogjeodezike)

Argumentimi: Kërkesa e mësipërme është përcaktuar bazuar në nenin 77, të ligjit nr. 162, datë 23.12.2020 “Për prokurimin publik”, nenin 39, pika 6/a, të VKM nr.285, datë 19.05.2021 “Për miratimin e Rregullave të Prokurimit Publik”, i ndryshuar si dhe ne Vendimin e Keshillit të Ministrave nr.42 datë 16.01.2008 “Për miratimin e rregullores për kriteret dhe Procedurat e dhënies së licensave profesionale të zbatimit, klasifikimit dhe disiplinimit të Subjekteve juridike që ushtrojnë veprimtari ndertimi”, i ndryshuar me VKM nr 92 .DT 19.02.2014 ku jane te percaktuar kategorite perkatese dhe niveli i klasifikimit per licensat e subjekteve qe ushtrojn veprimtari ne fushen e ndertimit.

Pikat e licensave jane percaktuar ne baze te zerave te pershkruara ne preventivin e projektit. Niveli i Shoqërisë sipas vlerave në lekë të punimeve të kryera për çdo kategori punimi.

Kategoria e kërkuar	Pershkrimi i kategorisë sipas legjislacionit të fushës	Zërat e punimeve që parashikohen të kryhen në preventiv, që përfshihen në kategorinë përkatëse	Niveli i klasifikimit i kërkuar për kategorinë respektive	Vlera e punimeve që parashikohen të kryhen në preventiv, që përfshihen në kategorinë përkatëse
NP-1	Punime gjurmimi në tokë.	Punime germim dheu	A	0-20 milion

NP-2	<i>Ndertime civile dhe industriale</i>	<i>Punime per ndertimin e mureve mbajtes dhe te objektit te</i>	A	0-20 milion
NP-3	<i>Rikonstr. dhe mirembajtje godinash civile e industriale, veshje fasadash</i>	<i>Punime per rikonstrukcionin e objektit</i>	A	0-20 milion
NP-12	<i>Punime të inxhinierisë së mjedisit</i>	<i>Punimet per ndertimin e objektit kane impakt mjedisor ne te gjithë zonen perreth saj duke pasur parasysh pozicionimin e saj ne zone urbane dhe brenda rrethimit te kopshtit dhe sasise se madhe te mbetjeve te gjeneruara nga punimet e prishjeve dhe germimeve dhe sistemimin e tyre</i>	A	0-20 milion
NS-1	<i>Punime per prishjen e ndertimeve</i>	<i>Prishje mure, betoneve, shtresa, suvatime, pllakave, catise, tavane ,cmontim dyer etj...</i>	A	0-20 milion
NS-2	<i>Impiante hidro-termosanitare dhe mirembajtja e tyre</i>	<i>Punime Hidro-Sanitare</i>	A	0-20 milion
NS-4	<i>Punime rifiniture muratures dhe lidhurame rifinitura material dr plastik, metalik xhami dhe rifinit te natyres tekn ndertuese</i>	<i>Ndertim mur tulle, suvatime, patinime, lyerje, veshje fasade me kapot, punime grafiato etj</i>	A	0-20 milion
NS-12	<i>Impiante teknologjike, termike dhe të kondicionimit</i>	<i>Sistemi i ngrohjes me kaldaje</i>	A	0-20 milion
NS-14	<i>Impiante te brendshme elektrike telefoni radiotelefoni TV</i>	<i>Rrjeti i brendshem elektrik dhe telefonise</i>	A	0-20 milion
NS-18	<i>Punime topogjeodezike.</i>	<i>Punimet per ndertimin e dhe pozicionimin e ambjenteve te reja te jashtme te kopshtit dhe lulishteve paraqesin nevojën e punimeve topogjeodezike</i>	A	0-20 milion

2.3.3 Operatori ekonomik duhet të paraqesi një dëshmi nga administrata

tatimore për punësimin mesatar jo më pak se 35 (tridhjetë e pesë) për një periudhë minimumi tre mujore të vërtetuar me;

- a) Vërtetim të lëshuar nga autoritetet përkatëse, në mënyrë elektronik e sipas formatit të përcaktuar nga legjislacioni në fuqi.

Argumentim: Ky kriter është vendosur në bazë të pikës 4, nenit 77, të ligjit nr 162 datë 23.12.2020 “Per Prokurimin Publik “ dhe nenit 39, **Pika 6/ç**, të VKM nr 285, datë 19.05.2021 “Per miratimin e Rregullave të Prokurimit Publik” i ndryshuar , me anë të këtij kriteri kërkohej që operatorët ekonomik të deshmojnë që kanë fuqi minimale puntore, të nevojshme për ekzekutimin e objektit të prokurimit. Autoriteti kontraktor në përcaktimin e fuqisë punetore të nevojshme për realizimin e kontratës ka bërë një përlllogaritje të saktë të numrit të punonjësve duke përcaktuar fillimisht orët e punës në bazë të analizës sipas manualit teknik të çmimeve të ndërtimit miratuar me VKM Nr 216 Datë: 13.04.2023” PËR KRIJIMIN DHE FUNKSIONIMIN E SISTEMIT TË INTEGRUAR PËR INFORMATIZIMIN E MANUALIT TË ÇMIMEVE PËR ZËRAT E PUNIMEVE NË NDËRTIM Në këtë kontekst ,autoriteti kontraktor ka përcaktuar numrin e punonjësve referuar një përlllogaritje të saktë të bërë referuar zërave të punimeve për objektin e prokurimit orëve të punës (8 orë në ditë për çdo punonjës) afatit kohor të realizimit të kontratës si dhe shpërndarjes së punës. Në numrin e përcaktuar për fuqinë punetore janë përlllogaritur stafit teknik dhe inxhinjerik si dhe stafit administrativ. Nga përlllogaritja e orëve të punës për çdo zë pune rezulton se për kryerjen e punimeve sipas grafikut të punimeve duhet 35 (tridhjetë e pesë) punonjës.

2.3.4 Operatorët ekonomik pjesëmarrës duhet të kenë të punësuar si staf teknik dhe të vërtetuar me kontratë pune të vlefshme, diplomë, CV, librezat e punës, si dhe të figurojnë në listpagesat e shoqërisë për minimumi tre muajt e fundit para hapjes së ofertave, si me poshte

- 1(një) Inxhinier Ndërtimi
- 1(një) Inxhinier Hidroteknik
- 1(një) inxhinier Elektrik
- 1(një) inxhinier Mekanik
- 1(një) Arkitekt
- 1(një) Inxhinier Mjedisi

Operatori ekonomik duhet të deklarojë si drejtues teknik të shoqërisë për ekzekutimin e këtyre punimeve një nga profesionet e mësipërme dhe drejtuesi ligjor duhet të deklarojë se drejtuesi teknik është i disponueshëm gjatë gjithë kohës së ekzekutimit të kontratës.

Ky kriter do të përmbushet nëpërmjet Formularit Përmbledhës të Vetëdeklarimit.

Argumentimi: Në bazë të pikës 4, të nenit të 77, të ligjit nr. 162, datë 23.12.2020 “Për prokurimin publik” dhe nenit 39, pika 6/c), të VKM nr.285, datë 19.05.2021 “Për miratimin e

Rregullave të Prokurimit Publik”, i ndryshuar. Me anë të këtij kriteri kërkohet që operatorët ekonomikë të dëshmojnë që kanë personelin e nevojshëm të kualifikuar për realizimin me sukses të kontratës. numri i inxhinierëve është përcaktuar nga pikëpamja e natyrës teknike të kontratës me qëllimin për të patur një rezultat sa më të mirë në mbarëvajtjen e punimeve..

Drejtuesit teknik kanë një rol të rëndësishëm në mbarëvajtjen e punimeve persa kohe ata janë përgjegjës për zbatimin e objektit sipas projektit dhe në përputhje me kushtet teknike të zbatimit të tij dhe për këtë është përcaktuar që drejtuesi teknik të ketë një nga profesionet që përputhen me zërat e punimeve që parashikohen në objekt.

2.3.5 Operatori ekonomik duhet të ketë të punësuar staf teknik për kryerjen e punimeve, të vërtetuar me kontratë punë të vlefshme, diplomë/dëshmi përkatëse lëshuar nga institucione të akredituara nga autoritetet përgjegjëse shtetërore, si dhe të figurojnë në listpagesat e shoqërisë minimumi për tre muajt e fundit të deklaruar me kohe të plote i më poshtë:

Murator 2
Hekurkthyes 1
Saldator 1
Hidraulik 1
Karpentier 3
Mekanik 1
Elektracist 2
Teknikë Ndërtimi 1
Pllakashtrues 2
Specialist Gipsi 2
Specialist për Sistemet Ngrohëse Ftohëse 2
Punonjës d/alumini 2
Suvatues 2
Bojaxhinj 2
Betonues 2
Hidroizolues 1

Ky kriter do të përmbushet nëpërmjet Formularit Përmbledhës të Vetëdeklarimit.

Argumentimi: Në bazë të pikës 4, të nenit të 77, të ligjit nr. 162, datë 23.12.2020 “Për prokurimin publik” dhe nenit 39, pika 6/c), të VKM nr.285, datë 19.05.2021 “Për miratimin e Rregullave të Prokurimit Publik”, me anë të këtij kriteri kërkohet që operatorët ekonomikë të dëshmojnë që kanë fuqine minimale punetore të nevojshme për ekzekutimin e objektit. Kriteri për punonjësit e mesipër lidhet ngushtësisht me objektin e kontratës, relacionin teknik dhe zërat e punimeve, duke

krijuar besueshmërinë se kane përvojën e duhur, si dhe personelin e nevojshëm, për të zbatuar kontratën. Për të përcaktuar numrin e punonjësve të kualifikuar të nevojshme për realizimin e kontratës, janë hartuar analizat teknike, sipas legjislacionit të fushës, konkretisht VKM Nr 216 Datë: 13.04.2023” PËR KRIJIMIN DHE FUNKSIONIMIN E SISTEMIT TË INTEGRUAR PËR INFORMATIZIMIN E MANUALIT TË ÇMIMEVE PËR ZËRAT E PUNIMEVENË NDËRTIM Konkretisht numri i punonjësve është ne perputhje me volumet e punes dhe llojit te tyre.

2.3.6 Operatori ekonomik duhet të disponojë punonjës të specializuar/të kualifikuar, si më poshtë me kontrate pune , certifikate te aftesise profesionale si dhe te figutoj ne list pagesen e shoqerise minimumi për periudhën tre muajt të deklaruar nga data e hapjes së ofertave:

- Eskavatoriste 1
- Automakiniste 1

***Argumentimi:** Në bazë të pikës 4, të nenit të 77, të ligjit nr. 162, datë 23.12.2020 “Për prokurimin publik” dhe nenit 39, pika 6/c), të VKM nr.285, datë 19.05.2021 “Për miratimin e Rregullave të Prokurimit Publik”, me anë të këtij kriteri kërkohet që operatorët ekonomikë të dëshmojnë që kanë fuqine minimale punetore te nevojshem per ekzekutimin e objektit. Kriteri për punonjesit e mesiperm lidhet ngushtësisht me objektin e kontrates, relacionin teknik dhe zërat e punimeve, duke krijuar besueshmërinë se kane përvojën e duhur, si dhe personelin e nevojshëm, për të zbatuar kontratën. Për të përcaktuar numrin e punonjësve të kualifikuar të nevojshme për realizimin e kontratës, janë hartuar analizat teknike, sipas legjislacionit të fushës, konkretisht VKM Nr 216 Datë: 13.04.2023” PËR KRIJIMIN DHE FUNKSIONIMIN E SISTEMIT TË INTEGRUAR PËR INFORMATIZIMIN E MANUALIT TË ÇMIMEVE PËR ZËRAT E PUNIMEVENË NDËRTIM). Konkretisht numri i punonjësve është ne perputhje me volumet e punes dhe llojit te tyre.*

Ky kriter do të përmbushet nëpërmjet Formularit Përmbledhës të Vetëdeklarimit.

2.3.7 Operatori ekonomik ofertues duhet të jetë i Certifikuar sipas standardeve ISO te lëshuara nga organizmat e vlerësimit te konformitetit te cilat janë te akredituara nga DPA ose nga organizmat ndërkombëtare akreditues te njohur nga Republika e Shqipërisë, konkretisht:

Çertifikatën e menaxhimit të cilësisë ISO 9001:2015 (**ose ekuivalente**) (e vlefshme).

(Në rastet e bashkimit të operatorëve ekonomik, çdo anëtar i grupit duhet të paraqesë ÇertifikatënISO)

Çertifikatën e menaxhimit Mjedisor ISO 14001-2015 (**ose ekuivalente**) (e vlefshme). (Në rastet e bashkimit të operatorëve ekonomik, çdo anëtar i grupit duhet të paraqesë Çertifikatën ISO).

Standard për manaxhimin e rreziqeve rreth shëndetit dhe sigurimit në punë **OHSAS 18001- 2007, (ose ekuivalente)** (e vlefshme). (Në rastet e bashkimit të operatorëve ekonomik, çdo anëtar i grupit duhet të paraqesë Çertifikatën ISO

***Argumentimi:** Në bazë të pikës 4, të nenit të 77, si dhe nenit nr. 79 të ligjit nr. 162, datë 23.12.2020 “Për prokurimin publik” dhe bazuar në nenin 44 pika 1, e VKM-së Nr.285, datë 19.5.2021 i ndryshuar. Për vet natyrën e veçantë, vendndodhjes dhe përmasat e objektit të kontratës që do të prokurohet, është tepër e rëndësishme që operatorët si zbatues, të kryejnë veprimtarinë me standardet e kërkuara të cilësisë. Sistemi i menaxhimit të cilësisë, mjedisit dhe shëndetit dhe sigurisë në punë janë standarte që çdo subjekt juridik apo privat e ka qëllim në arritjen e suksesit. Këto certifikata lidhen ngushtësisht me objektin e kontratës përse kohë do të pronohen edhe ekuivalentet e tyre dhe i shërbejnë autoritetit kontraktor për njohjen e kapaciteteve të operatorëve ekonomikë dhe të mundësisë së tyre për përmbushjen e plotë të kontratës. Referuar në nenin 79 të ligjit 162/2020, parashikohet se autoriteti kontraktor mund të kërkojë certifikata, të lëshuara nga organe të pavarura, që vërtetojnë pajtueshmërinë e kandidatit ose të ofertuesit me standardet e kërkuara të cilësisë, përfshirë edhe standardet për menaxhimin e mjedisit, shëndetit dhe sigurisë në punë.*

“ Duke qenë se përfituesi direkt i kontratës objekt prokurimi është Autoriteti Kontraktor, gëzon të drejtën për t’u garantuar se operatorët ekonomikë pjesëmarrës i plotësojnë kërkesat e cilësisë për punët që do të kryhen, e rrjedhimisht është e drejtë e këtij të fundit t’u kërkojë ofertuesve të paraqesin certifikata të lëshuara nga organe të pavarura të njohura nga Sistemet e Standardizimit Kombëtar ose Ndërkombëtar ”.

Për ISO 9001 - 2015; Kjo certifikate specifikon kërkesat për një sistem të menaxhimit të cilësisë, ku një operator ekonomik duhet të tregojë aftësinë e tij që vazhdimisht të sigurojë punë/mallra ose shërbime që plotësojnë kërkesat e aplikueshme ligjore dhe rregullatore.

Per ISO 14001 – 2015: Eshtë kërkuar që kandidatët ofertues të jenë të pajisur me standartin ISO 14001 – 2015 , standart ky që vlerëson sipas përkufizimit të tij përgjegjshmërinë e kompanive ndaj mjedisit dhe fokusohet në tre fusha kryesore:

Për ISO OHSAS 18001:2007 ose ISO 45001-2018

Ky standart përcakton kërkesat minimale të shëndetit në punë dhe praktikën më të mira të menaxhimit të sigurisë. Ky lloj standarti konsiston në sigurimin e një sistemi shëndetësor optimal dhe menaxhimin e sigurisë në punë. Kjo mund të ndihmojë për të vënë në vend politikën, procedurat dhe kontrollin e nevojshme për çdo lloj biznesi për të arritur kushtet më të mira të mundshme të punës, një linjë me praktikën më të mirë të njohur ndërkombëtare

2.3.8 Operatori ekonomik duhet te disponoje mjetet dhe paisjet e nevojshme teknike per realizimin e kontrates. Per kete duhet te paraqese deshmi per mjetet dhe paisjet teknike qe ka ne dispozicion apo mund t'i vihen ne dispozicion/ kontrate sherbimi operatorit ekonomik.

a) Kerkohen te jene ne dispozicion keto mjete pune:

Nr	Emri i mjetit/pajisjes	Njesi	Sasi	Statusi
1	Eskavator me goma	Copë	1	Në pronësi ose me qira
3	Mjet autovinç 7-8 ton	Copë	1	Në pronësi ose me qira
4	Kamion vetëshkarkues me kapacitet mbajtës jo me pak se 20 ton	Copë	1	Në pronësi ose me qira
5	Kamioncine vetëshkarkues me kapacitet mbajtës 1-3 ton	Copë	2	Në pronësi ose me qira
6	Autobot uji 2000 l e lart	Copë	1	Në pronësi ose me qira
7	Skela metalike	m2	800	Në pronësi ose me qera
8	Pompa uji elektrike/djegje te brendshme	Copë	1	Në pronësi ose me qira
9	Vibruese betoni elektrike /djegie te brendshme	Copë	1	Në pronësi ose me qira
10	Betoniere dore	Copë	1	Në pronësi ose me qira
11	Saldatrice	Copë	1	Në pronësi ose me qira
12	Rul cat	Cope	1	Në pronësi ose me qira
13	Minifadrome	Cope	1	Në pronësi ose me qera
14	Autobetoniere vetengarkuese 2.5-3 ton	Cope	1	Në pronësi ose me qera
15	Motogjenerator trefazor	cop	1	Në pronësi ose me qera
16	Freksibel dore	cop	1	Në pronësi ose me qera
17	Matrapik dore elektrik/djegje te brendshme	cop	1	Në pronësi ose me qera
18	Betoforma druri/metalike	m2	200	Në pronësi ose me qera

Si dëshmi për të vërtetuar disponimin e mjeteve dhe pajisjeve teknike ne pronesi/qira /kontrate furnizimi do të paraqiten keto dokumenta:

1- Për mjetet në pronësi duhet të paraqitet:

- *dokumenti që verteton regjistrimin e mjetit (akti i pronësisë);*
- *leje qarkullimi;*
- *çertifikate e kontrollit teknik;*
- *siguracion mjeti, (i vlefshëm);*

2-Për mjetet e deklaruara me qera duhet të paraqitet:

- *kontrata përkatëse noteriale e qerasë e cila duhet të jetë e vlefshme për të gjithë periudhën e realizimit të kontratës, objekt i këtij prokurimi*
- *leje qarkullimi;*
- *çertifikaten e kontrollit teknik,*
- *siguracion mjeti (i vlefshëm);*

Te paraqiten mjete dhe pajisje të mbrojtjes në punë të punëtorëve, dhe personelit si më poshtë:

- *Kokore 35 copë*
- *Rripa lidhës sigurimi për punime në lartësi minimumi 3 copë*
- *Fikëse zjarri të lëvizshme minimumi 2 copë*
- *Komplet i ndimës së shpejtë minimumi 2 copë*

Keto paisje duhet te deklarohen tek formulari permbledhes i vetedeklarimit.

2.3.9 Operatori ekonomik duhet të paraqesë Autorizim Prodhuesi/Distributori, Certifikata ISO Prodhuesi/Distributori, Katalog per :

- Kaldaja me pelet

Ky kriter është vendosur për shkak të specifikës që ka kjo paisje e cila do të importohet nga vendet e tjera prodhuese dhe për këtë paisje subjekti duket të paraqesë autorizimet që e shoqerojnë paisjen.

Të gjitha dokumentet duhet të jenë origjinale ose kopje të noterizuara.

Rastet e mosparaqitjes së një dokumenti, ose dokumente false dhe të pasakta, konsiderohen kushte për skualifikim
